



Pranuar me dt. 13.01.2025			
Nr. lista organa	Num	Nr. Ekzempl.	Vlerë
	72		

UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
"ISA BOLETINI"
FAKULTETI JURIDIK

Pranuar me dt. 13.01.2025			
Nr. lista organa	Numer	Nr. Ekzempl.	Vlerë
	14		

Rr. Ukshin Kovaçica, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
<http://www.umib.net>; Tel: +381-28535725/535727

PËR:	Prof. Dr. Nurten Deva - Rektore e Universitetit "Isa Boletini" të Mitrovicës dhe Kryesuese e Senatit; Prof. Asoc. Dr. Muharrem Zabeli – Prorektor për mësimdhënie dhe Çështje të Studentëve;
CC:	Avdyl Beqiri – Sekretar i përgjithshëm i UIBM;
NGA:	Prof. Asoc. Dr. Islam Qerimi – Dekan dhe Kryesues i Këshillit të Fakultetit Juridik;
TEMA:	Raporti i punës së Fakultetit Juridik për vitin akademik 2023 - 2024



E nderuar Rektore,

Përmes kësaj shkrese ju përcjellim Raportin e Punës së Fakultetit Juridik për vitin akademik 2023 – 2024, i cili është miratuar në mbledhjen e Këshillit të Fakultetit e mbajtur me 13.01.2025.

Me respekt,

Pranuar me dt. 13.01.2025			
Njësia orga	Num	Nr.Ekzëm	Vlera
	7211		

Pranuar me dt. 13.01.2024			
Njësia orga:	Numer	Nr.Ekzëmpl.	Vlera
	1114		




UNIVERSITETI "ISA BOLETINI" MITROVICË
UNIVERSITY "ISA BOLETINI" MITROVICA

FAKULTETI JURIDIK

Rr. Ukshin Kovaqica, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës

<http://www.umib.net>; Tel: +381-28535725/535727

RAPORTI I PUNËS I FAKULTETIT JURIDIK PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024



Mitrovicë, Janar 2025

Përmbajtja

1. Procesi i Akreditimit.....	3
2. Të dhënat për personelin akademik të rregullt, angazhuar dhe stafin administrativ	4
3. Procesi i mbarëvajtjes së mësimit (përqindja e realizimit të mësimit online dhe fizikisht) .	6
4. Procesi i realizimit të provimeve	7
5. Mbledhjet dhe aktivitete e këshillit të fakultetit	7
6. Bashkëpunimi i fakultetit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar	8
7. Organizimi i Tryezave Shkencore nga Fakulteti Juridik	8
8. Organizimet brenda Fakultetit	11
9. Procesi i regjistrimit të studentëve, transferimet dhe numri i të diplomuarve.....	11
10. Të dhënat për aktivitete shkencore të stafit akademik dhe studentëve	13
11. Planifikimet e përgjithshme	15

1. Procesi i Akreditimit

Fakulteti Juridik është akredituar me vendimin nr. 548/14, të datës 04.07.2014, i lëshuar nga Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) i Agjencinë së Kosovës për Akreditim (AKA).

Është ri-akredituar me Vendimin nr. 535/2017, të datës 06.07.2017, nga Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) i Agjencinë së Kosovës për Akreditim (AKA), për periudhën 3 vjeçare.

Vizita e Ekspertëve të AKA-së në Fakultetin Juridik është realizuar më datë 26.05.2017. Implementimi i rekomandimeve të dhëna nga Ekipi i Ekspertëve Ndërkombëtar ka filluar të realizohet nga muaji shtator 2017. Programi i ri-akredituar ka adresuar të gjitha kërkesat nga procesi paraprak i akreditimit.

Ndërkohë, me Vendimin nr. 465/18D, të datës 18.05.2018, e Këshilli Shtetëror të Cilësisë (KSHC) i Agjencinë së Kosovës për Akreditim (AKA), është zgjatur periudha e akreditimit edhe për 1 (një) vit, deri më 30 (tridhjetë) shtator 2021.

Në vitin 2021, Fakulteti Juridik është ri-akredituar me Vendimin nr. 3022/21, të datës 12.08.2021, nga Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) i Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për periudhën 3 vjeçare.

Vizita e Agjencinë së Kosovës për Akreditim (AKA) dhe Ekspertëve Ndërkombëtar në Fakultetin Juridik është realizuar në vazhdim më datë 22.03.2021. Programi i ri-akredituar ka adresuar të gjitha kërkesat nga procesi paraprak i akreditimit.

Implementimi i rekomandimeve të dhëna nga Ekipi i Ekspertëve Ndërkombëtar ka filluar të realizohet nga muaji nëntor 2021.

Vizita e Agjencinë së Kosovës për Akreditim (AKA) dhe Ekspertëve Ndërkombëtar në Fakultetin Juridik është realizuar për herë të fundit më datë 12.03.2024. Programi i ri-akredituar ka adresuar të gjitha kërkesat nga procesi paraprak i akreditimit. Në vitin 2024, Fakulteti Juridik është ri-akredituar me Vendimin nr. 1079/24, të datës 30.05.2024, nga Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) i Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për periudhën 3 vjeçare.

2. Të dhënat për personelin akademik të rregullt, angazhuar dhe stafin administrativ

Gjatë vitit akademik 2023-2024, kanë qenë në marrëdhënie të rregullt dhe të angazhuar të punës këta profesorë dhe asistentë:

Tabela nr. 1 Paraqitja e të dhënave për personelin akademik me kohë të plotë

Emri	Mbimeri	Kualifikimi	Titulli akademik	Kohezgjatja e kontrates	Ngarkesa mësimore/ Semestri - orë/javë	Ngarkesa për provime në orë/vit	Këshillim - orë/javë	Veprimtaritë administrative-orë/javë	Ngarkesa e punës për orë/javë kërkimore	Orët e përgatitjes mësimore/javë
Islam	Qerimi	Dr.iur.	Prof.Asoc	2024	6 + 6	30	3+3	3+3	+12	+18
Agron	Beka	Dr.sc.	Prof.Asoc	2024	6 + 6	25	3+3	3+3	+10	+15
Halil	Bajrami	Dr.sc	Prof.Asoc	2025	6 + 6	15	2+2	3+3	+8	+10
Arta	Dauti	Dr.sc	Prof.Ass	2024	8 + 4	20	3+3	3+3	+8	+15
Mimoza	Aliu	Dr.sc	Prof.Ass	2024	6 + 6	30	3+3	3+3	+8	+15
Përparim	Gruda	Dr.sc	Prof.Ass	2024	6 + 6	30	3+3	3+3	+10	+15
Zahir	Çerkini	Dr.sc	Prof.Ass	2024	+ 6	25	4+3	3+3	+8	+18
Arbnor	Ajeti	Dr.sc	Prof.Ass	2024	8 + 8	30	3+3	3+3	+8	+15
Besnik	Murati	Dr.sc	Prof.Ass	2024	2 + 10	30	3+3	3+3	+10	+15
Xhemajl	Veliqi	LLM	Ass	2024	11 +10	15	3+3	2+2	+8	+20

Tabela nr. 2. Paraqitja e angazhimit të stafit akademik me kohë të plotë (FL) sipas fushës së studimit dhe fushave kërkimore

Profesor	Grada shkencore	Fusha e studimit/fusha e kërkimit
Islam Qerimi	Dr.sc	E drejta penale
Agron Beka	Dr.sc	E drejta penale
Halil Bajrami	Dr.sc	Ekonomia
Përparim Gruda	Dr.sc	E drejta kushtetuese dhe administrative
Arta Dauti	Dr.sc	E drejta civile
Mimoza Aliu	Dr.sc	E drejta civile
Zahir Çerkini	Dr.sc	E drejta kushtetuese dhe administrative
Arbnor Ajeti	Dr.sc	E drejta civile
Besnik Murati	Dr.sc	E drejta ndërkombëtare
Xhemajl Veliqi	LLM	E drejta penale

Stafi akademik me angazhim:

- Prof. asoc. dr. Besim Gollopeni
- MSc. ass. Milaim Mehmeti
- MSc. Ylli Hashani PhD (c)
- Msc. Albulena Uka – PhD (c)
- MSc. Argjent Behrami
- MSc. Jeton Hasani

Stafi administrativ:

- Bahrie Sadiku- Sekretare;
- Suzana Halili-Zyrtare;
- Shpat Musliu- Zyrtar.

3. Procesi i mbarëvajtjes së mësimit (përqindja e realizimit të mësimit online dhe fizikisht)

Në vitin akademik 2023 - 2024, Fakulteti Juridik në përgjithësi ka realizuar procesin mësues fizik. Mirëpo, duke u bazuar edhe në Rregulloren e UIBM-it, si dhe të FJ, përpos mënyrës së mbajtjes të mësimit me pjesëmarrje fizike, është mbajtur edhe mësimi online.

Mësimi në semestrin dimëror 2023-2024 ka filluar nga data 02.10.2023 dhe ka zgjatur deri më 30 janar 2024. Ndërsa, mësimi në semestrin veror ka filluar më 01.03.2024, dhe ka zgjatur deri më datë 15.6.2024, kur kanë përfunduar ligjëratat për semestrin veror të vitit akademik 2023/2024.

Mësimi në dy semestrat ka përfunduar me sukses, duke u realizuar në tërësi plan programi i njësisë tonë akademike për vitin akademik 2023 - 2024. Në dy semestrat e vitit akademik 2023 - 2024 mësimi është zhvilluar nga 15 javë.

Gjatë vitit 2023, Profesori i Fakultetit Juridik Zahir Çerkini ndjekur programin Fulbright në Universitetin Ohio në SHBA. Zëvendësimin/mbajtjen e Ligjëratave në semestrin dimëror të vitit akademik 2023/2024 për Prof. ass. dr. Zahir Çerkini, i cili e ka ndjekur programin Fulbright në Universitetin Ohio, e kanë mbajtur Prof. asoc. dr. Islam Qerimi dhe Prof. ass. dr. Përparim Gruda.

Dekani i Fakultetit Juridik të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë, Prof. Asoc. Dr. Islam Qerimi, me ftesë të Dekanit të Fakultetit të Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare të Universitetit të Varshavës, Prof. Dr. hab. Daniel Przystek, qëndroi në cilësinë e profesorit musafir (visiting professor) në periudhën kohore prej 23.07.2024 deri më 01.08.2024. Këtë mundësi ia ofroi Universiteti i Varshavës.

Këshilli i Fakulteti Juridik ka bërë kërkesë për angazhimin e tre asistenteve si bashkëpunëtorë të jashtëm, për mbajtjen e ushtrimeve në fushat e së drejtes kushtetuese, administrative, nderkombetare dhe civile. Kjo kërkesë është aprovuar nga Senati i UIBM. Asistentet e angazhuar i kanë mbajtur ushtrimet në përputhje me syllabuset e lendeve perkatëse. Sipas Vendimit të Këshillit të FJ i cili bazohet në rekomandimet e Ekspertëve Ndërkombëtar të ri-akreditimit është paraparë mundësia që në disa raste ligjëratat dhe ushtrimet të mbahen edhe në formën Online.

4. Procesi i realizimit të provimeve

Organizimi i provimeve është bërë sipas afateve të caktuara me Statutin e Universitetit dhe Vendimeve të Senatit të Universitetit.

Provimet janë mbajtur fizikisht, me shkrim, me gojë ose në formë kombinuar. Mënyra e kombinuar e provimeve me gojë dhe me shkrim është zbatuar në të gjitha afatet, janar, prill, qershor, shtator, tetor (afat i jashtëzakonshëm). Kjo formë e mbajtjes së provimeve është bërë me qëllim të zhvillohen shkathtësitë e nevojshme të të shprehurit tek studentët, si dhe të matet me saktësi shkalla e njohjes së lëndës konkrete. Kjo metodë ka dhënë rezultate e saja, pasi sipas deklarimeve të studentët ka ndikuar që ata të vijnë më të përgatitur në provime.

5. Mbledhjet dhe aktivitete e këshillit të fakultetit

Këshilli i Fakultetit Juridik gjatë vitit akademik 2023 - 2024 ka mbajtur mbledhje te rregullta dhe te jashtëzakonshme. Gjatë këtyre mbledhjeve është diskutuar dhe vendosur për një sërë çështjesh si: përgatitja dhe dërgimi i raportit të vetëvlerësimit të programit Bachelor të FJ; mbrojtja me suksesë e programit bachelor; draftimi i raportit të përmirësimit mbi zbatimin e rekomandimeve të vlerësimit të jashtëm për programin bachelor; miratimi i syllabuseve të shqyrtuara nga Komisioni i Studimeve i FJ; formimin e komisioneve përkatëse në kuadër të njësisë akademike dhe propozimet në nivel qendror. Iniciativa për bashkë organizimin e një konference shkencore me Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës gjatë vitit 2024. Iniciativa për pjesëmarrje në konference shkencore ndërkombëtare në Fakultetin Juridik të Universitetit të Shkodres “Luigj Gurakuqi”; miratimi i raportit vjetor të punës për vitin 2023 i Fakultetit Juridik; njoftimi i menaxhmentit dhe trajtimi i aktiviteteve me karakter ndërkombëtar për memorandumet e bashkëpunimit si dhe implementimin e tyre në praktikë!

Propozimet për shpalljen të konkursit për tre asistent të angazhuar për vitin akademik 2023 -24:

- Një asistent për lëndët E drejta kushtetuese, E drejta kushtetuese krahasuese, E drejta e punës, Fillet e së drejtës;
- Një asistent për lëndët civile;
- Një asistent për lëndët nga E drejta ndërkombëtare.

Propozimet për shpalljen të konkursit për avansim:

- Prof. ass. dr. Përparim Gruda.

6. Bashkëpunimi i fakultetit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar

Gjatë vitit akademik 2023 - 2024, janë organizuar takime të Menaxhmentit të FJ-së, me qëllim të arritjes së memorandumeve të bashkëpunimit të njësisë tonë akademike me institucionet e ndryshme publike dhe private të Republikës së Kosovës dhe në nivel ndërkombëtar. Dekani i Fakultetit Juridik në Universitetin "Isa Boletini" në Mitrovicë Prof. asoc. dr. Islam Qerimi ka arritur memorandum bashkëpunimi me:

- Oda e Ndërmjetësuesve të Kosovës;
- Fakulteti Juridik i Zagrebit (Kroaci);
- Fakulteti i Gjeoshkencave (UIBM);
- Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS);
- Albanian institute of cultural studies (AICS);
- Qendra për Drejtësinë Humanitare Kosovë (QDHK);
- Instituti i Studimeve Politike (Tiranë).

Gjithashtu, gjatë muajit tetor dhe nëntor 2023 janë realizuar disa vizita për studentët e Fakultetit Juridik të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë si p.sh.: në Gjykatën Themelore të Mitrovicës-Dega në Vushtrri, Departamenti për Krime të Rënda, për raste nga fusha penale, si dhe në Institutin e Mjekësisë Ligjore në Prishtinë, ku ata kanë përcjellur edhe demonstrime të ndryshme të drejtëpërdrejta të cilat zhvillohen aty nga ekspertët e këtyre lamive.

Gjatë vitit 2023, Profesori i Fakultetit Juridik Zahir Çerkini ndjekur programin Fulbright në Drake University ne Iowa te SHBA. Profesori Islam Qerimi gjatë ka marrë pjesë në 5 kollokviume të zhvilluara në Institutin Kërkimor Kriminologjik të Hanoverit në Gjermani. Gjithashtu, gjatë semestrit veror 2024 janë realizuar disa vizita për studentët e Fakultetit Juridik të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë si p.sh.: OSBE - Prishtinë, EULEX - Prishtinë, ku ata kanë përcjellur edhe aktivitete të ndryshme të drejtëpërdrejta të cilat zhvillohen aty nga ekspertët e këtyre lamive.

7. Organizimi i ligjëratave e aktiviteteve të stafit akademik, si dhe me profesor të jashtëm dhe Konferencave dhe Tryezave Shkencore nga Fakulteti Juridik

Stafi akademik në vitin akademik 2023 - 2024 është angazhuar në paraqitjen në konferenca ndërkombëtare dhe publikimin e punimeve në revistat ndërkombëtare. Stafi akademik i Fakultetit Juridik në vitin kalendarik 2023 - 2024 është angazhuar në paraqitjen në konferenca ndërkombëtare dhe publikimin e punimeve në revistat ndërkombëtare. Në përputhje me

planifikimin strategjik, stafi akademik ka kontribuar në hulumtimin interdisiplinor duke marrë pjesë me prezentime në konferencën ndërkombëtare të organizuar nga Fakulteti i Gjeoshkencave në UMIB. FJ, për të rritur komponentët e ndërkombëtarizmit dhe multidisiplinaritetit në hulumtim, ka arritur marrëveshje interne bashkëpunimi me njësinë akademike brenda UMIB Fakultetin e Gjeoshkencave, me universitete në rajon dhe me universitete në vende antare të Bashkimit Evropian. Po ashtu, një pjesë e stafit akademik ka botuar libra dhe punime me kolegë nga universitetet tjera brenda dhe jashtë vendit. Disa nga ligjëratat dhe aktivitetet me profesor të jashtëm, Tryezat dhe Konferencat Shkencore nga Fakulteti Juridik dhe takimet janë mbajtur si më poshtë:

- U mbajtë ligjëratë e hapur me profesorin Haki Demolli nga UP, me temë: “TERRORIZMI NË SHOQERINË BASHKËKOHORE”;
- Dekani i Fakultetit Juridik, ka zhvilluar takim për implementim të memorandumit të bashkëpunimit me nënkryetarin e Gjykatës Themelore të Mitrovicës, Bekim Veliqi;
- Fakulteti Juridik bashkëpunon me Institutin për Studime Evropiane dhe Globale (ISEG);
- Studentët e Juridikut kanë prezantuar përvojat e tyre si pjesë e një projekti për drejtësi;
- Asistenti i Fakultetit Juridik, Xhemajl Veliqi është zgjedhur Ombudsman i UIBM;
- Fakulteti Juridik ka filluar bashkëpunimin me Platformen Lexdoks (Legal Data Solutions L.L.C);
- Në Fakultetin Juridik u zhvillua gjykimi i simuluar nga studentët e Fakultetit Juridik;
- Fakulteti Juridik ka ndrë mirënjohje për stafin akademik dhe administrativ;
- Përfaqësues të KFOR-it zviceran vizituan Fakultetin Juridik;
- Youth Initiative for Human Rights- Kosovo (YIHR) për studentët e Fakultetit Juridik të UIBM, mbajti ligjëratë të hapur me temë: “Nisma e të rinjëve për drejtësi”;
- Në Fakultetin Juridik u mbajtë ligjëratë e hapur për studentët e kursit të kriminalistikës;
- Faqja zyrtare e fejsbukut për Fakultetin Juridik: Juridik/Faculty of Law – UIBM;
- Profesori i Fakultetit Juridik të UIBM-it, Përparim Gruda mbajti prezantim në Institutin e së Drejtës dhe Marrdhënieve Ndërkombëtare të Universiteti të Gracit në Austri;
- Graz International Law Discussion Series (GILDS);
- Studentët e Fakultetit Juridik pjesëmarrës në vizitë studimore në seancë gjyqësore;
- Dekani i Fakultetit Juridik zhvilloi takim me përfaqësueset e FINCA;
- Në Fakultetin Juridik të UIBM-it, u realizua aktiviteti i radhës i natyrës së mësimi dual teorik – praktik të studentëve;

- Në Fakultetin Juridik të UIBM-it, u realizua bashkëligjëratë e hapur me avokaten Hidajete Mazhiqi;
- Fakulteti Juridik bashkëpunon me Odën e Ndërmjetësuesve të Kosovës (ONDK);
- Tituj të rinj për Bibliotekën Universitare;
- Në Fakultetin Juridik u mbajtë ligjëratë e hapur me hulumtuesin norvegjez Josef Martinsen;
- Në Fakultetin Juridik u organizua ligjëratë e hapur me Policinë e Kosovës;
- Biblioteka e Fakultetit Juridik dhe ajo e UIBM-së, u pasurua edhe me një tekst të ri universitar me titull “Gjyqësia kushtetuese”;
- Fakulteti Juridik dhe LEXdoks filluan implementimin praktik të Memorandumit të Bashkëpunimit;
- Një delegacion i UIBM-it (edhe dy profesorë të Fakultetit Juridik) ka qëndruar për vizitë në University of Eastern Finland në kuadër të programit Erasmus+;
- Fakulteti Juridik përmbyll me profesorin Bashkim Preteni nga FJ i UP, ciklin e ligjëratave nga profesorët vizitorë.
- Profesori Islam Qerimi përzgjedhet **si më poshtë**:
- Scientific advisor/expert on conflict resolution processes in countries of origin (Albania/Kosovo) (Volunteer) 2024 – **FRIMAP Partner UG** – Germany.
- Reviewer (Recensent) **Časopis Policija i sigurnost - Ministarstvo unutarnjih poslova Ravnateljstvo policije Hrvatske**. Policijska akademija „Prvi hrvatski redarstvenik”. bibliographic databases Ulrich's Periodicals Directory, Elektronische Zeitschriftenbibliothek/Electronic Journals Library and Web of Science Core Collection (ESCI);
- Reviewer The **Journal of Infrastructure, Policy and Development (JIPD)**;
- Reviewer **Substantive Justice International Journal of Law (SIJL)**;
- Member of the Scientific Board of **Przegląd Europejski/European Studies Quarterly** published by Faculty of Political Science and International Studies of the University of Warsaw;
- Reviewer of **Politics, Religion & Ideology – Journal**, Registered in England & Wales No. 3099067 5 Howick Place | London | SW1P 1WG;
- Reviewer of Hiperborea the journal of the **Balkan History Association**. PENN STAATE UNIVERSITY PRESS.
- Honorary head of department for retreats abroad, further training and foreign language skills as well as representative for international affairs as the technical organizer of the annual excursion abroad - in order to promote the European context at a technical level. **Gesellschaft für Kriminologie, Polizei und Recht e.V.** (Volunteer).
- Recensent i Monografisë: “**Krimi i organizuar**”, 11.02.2023; Authorë: Mensur Morina & Florent Azemi, ISBN: 978-9951-9140-7-9.

8. Organizimet brenda Fakultetit

Gjatë vitit akademik 2023 - 2024 është bërë implementimi në vazhdimësi i rekomandimeve të dhëna në raportin final të Ekspertëve Ndërkombëtar në procesin fundit të ri-akreditimit për Fakultetin Juridik (2021).

Stafi i Fakultetit Juridik gjatë vitit akademik 2023 - 2024 ka diskutuar lidhur me planet dhe projektet për vitin akademik. Ndër temat e diskutuara ishte Riakreditimi i programit Bachelor të Fakultetit Juridik dhe implementimi i rekomandimeve të eksperteve të jashtëm të këtij programi.

Në Fakultetin Juridik nga grupi punues janë mbajtur disa takime për draftimin e Raportit të Përmirësimit të Implementimit të rekomandimeve të eksperteve të jashtëm për programin Bachelor.

Stafi Akademik i Fakultetit Juridik ka ndjekur trajnimin e përvetësimit të shkathtësive në Stafi Akademik i Fakultetit Juridik ka ndjekur trajnimin për Mural Whiteboard, nga zyra e teknologjisë së informacionit të UIBM-së.

Si rrjedhojë e Memorandumit të arritur për bashkëpunim ndërmjet Fakultetit Juridik të UIBM-it dhe të Universitetit të Zagrebit, dekani i Fakultetit Juridik të UIBM, Prof. asoc. dr. Islam Qerimi ka pranuar ftesë me shkrim nga dekani i Fakultetit Juridik të Universitetit të Zagrebit, Prof. dr. Ivan Koprivic, për shkëmbimin e stafit akademik.

9. Procesi i regjistrimit të studentëve, transferimet dhe numri i të diplomuarve

Në Vendimin nr. 3022/21, të datës 12.08.2021 nga Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) i Agjencionit të Kosovës për Akreditim (AKA), Fakulteti Juridik është akredituar për regjistrimin e 80 studentëve, dhe në Fakultetin Juridik janë regjistruar po aq studentë të rinjë.

Numri i studentëve aktiv sipas viteve të studimeve dhe totali : 2023/2024


Viti i studimeve	1			2			3			4			
Fakulteti Juridik	Total	F	M	Total	F	M	Total	F	M	Total	F	M	Total
Programi: Juridik	80	65	15	44	38	6	49	44	5	75	57	18	248
Total	80	65	15	44	38	6	49	44	5	75	57	18	248

Programi: Juridik



Numri i studentëve të regjistruar : 2023/2024 - Bachelor

Fakulteti Juridik	Total	F	M	Total
Programi: Juridik				79
Prç				79



Numri i studentëve të diplomuar : 2023/2024 – Bachelor

Fakulteti Juridik	Total	F	M	Total
Programi: Juridik	25	22	3	25
Total	25	22	3	25

10. Të dhënat për aktivitete shkencore të stafit akademik dhe studentëve

Autori/ Autoret	Titulli i punimit në reviste/ Konferencë	Emri i revistës/ Konferencës
Islam Qerimi	<ol style="list-style-type: none"> 1. Artificial Intelligence Technology and Human Rights 2. The Importance of Theory and Scientific Theories for the Scientific Study of Genocide in the Context of the Contribution to the Development of the Science of Genocide 3. HUMAN TRAFFICKING IN WESTERN BALKAN: CASE STUDY OF KOSOVO 4. Analysing the ICJ’s advisory opinion on Kosovo's independence: a multilateral perspective 5. Informelle Konfliktschlichtung nach albanischem Kanun. Eine 	<p>SCOPUS - Journal of Criminology, 2023, 15(4), pp. 377–388.</p> <p>SCOPUS - Academic Journal of Interdisciplinary, 2023, 12(1), pp. 183–200.</p> <p>SCOPUS - Access to Justice in Eastern Europe., 2024, 7(1), pp. 390–403.</p> <p>EBSCO- Przegląd Europejski. European Studies Quarterly, ISSN: 1641-2478, vol. 2023, no. 4</p> <p>DOAJ- ISBN-10 3959356064, ISBN-13 : 978-3959356060, (MONOGRAFI),</p>

	rechtsvergleichende Analyse zum alten Kanun und modernen Recht, 2. überarbeitete und ergänzte Auflage (Monographie),	disserta Verlag, ein Imprint der Bedey & Thoms Media GmbH - Hermannstal 119k D – 22119 Hamburg (Germany), 2023.
Halil Bajrami	<ol style="list-style-type: none"> 1. Assessing the level of satisfaction with white tourism with Kosovar consumers 2. Financing and staff training in tourism: a case study in the developing country 3. Enhancing organizational performance through effective leadership and communication 4. Strategies For Upholding Ethical Standards: Best Practices For Managers In Fostering A Culture Of Ethics In Organizations 	<p>SCOPUS - Quality - Access to Success 2023, 24(197), pp. 84–90</p> <p>SCOPUS - Journal of Governance and Regulation, 2023, 12(3 Special Issue), pp. 324–333</p> <p>SCOPUS - Edelweiss Applied Science and Technology., 2024, 8(4), pp. 1810–1821</p> <p>SCOPUS- Quality - Access to Success, 2024, 25(199), pp. 348–355</p>
Besnik Murati	<ol style="list-style-type: none"> 1. Discrimination in Kosovo Under Domestic and International Legislation 2. Annexation of Kosovo and the role of preventive diplomacy 3. Harmonization of the legislation of foreign investments of the developing countries with that of the european 4. Kosovo Relations in the Regional Context 	<p>SCOPUS - Journal of Human Rights and Social Work, 2023 8(3), pp. 339–347</p> <p>SCOPUS - International Journal of Public Law and Policy 2023, 9(3), pp. 239–250</p> <p>SCOPUS - Journal of Governance and Regulation 2023, 12(1 Special Issue), pp. 348–358</p> <p>SCOPUS- Dirasat: Human and Social Sciences, 2024, 51(1), pp. 373–381</p>
Arbnor Ajeti	<ol style="list-style-type: none"> 1. The Consumer Protection Law in Kosovo and its Harmonisation with the EU Legislation 	SCOPUS- Krytyka Prawa, 2024, 16(3), pp. 182–199

Përparim Gruda	<ol style="list-style-type: none"> 1. The Constitutional Relevance of the ECHR in Domestic Law: The Kosovo Perspective 2. European Integration of Kosovo: Analysis of the Kosova Constitutional Provisions that Require Harmonization with EU Law 	<p>SCOPUS- Law and Development Review., 2024, 17(1), pp. 233–261</p> <p>SCOPUS - Baltic Journal of Law and Politics, 2024, 16(2), pp. 82–97</p>
Zahir Cerkini	<ol style="list-style-type: none"> 1. HOW THE CONSTITUTION SHAPES ECONOMIC GOVERNANCE: BALANCING LAW AND ECONOMICS IN POST-WAR COUNTRIES 	<p>SCOPUS - Corporate Law & Governance Review, 2024, 6(2), 83–92</p>

11. Planifikimet

Gjatë vitit akademik 2023 - 2024, prioritet kryesorë i Fakultetit kanë qenë;

- riakreditimi i programit Bachelor -, si dhe
- rekrutimi i stafit akademik, përkatësisht asistentëve të angazhuar për lëndët e sipërcekura.

Gjithashtu, ndër prioritetet tona ishte edhe zgjerimi i rrjetit të bashkëpunimit dhe angazhimi në projekte lokale dhe ndërkombëtare (hulumtime, shkëmbim të stafit akademik dhe studentëve, projekte të aplikueshme etj) me impakt pozitiv në zhvillimin e stafit akademik, studentëve dhe komunitetit. Ndër projektet më të rëndësishme ishte edhe vazhdimi i pjesëmarrjes së studentëve në praktikën profesionale tre mujore në Gjykatën Themelore në Mitrovicë si dhe të Degës në Vushtri.

Mbështetje për stafin akademik për zhvillim profesional dhe akademik përmes pjesëmarrjes në trajnime, konferenca, seminare, studime të avancuara, publikime etj.

Gjatë vitit akademik 2023 - 2024 FJ ka pasur disa aktivitetet si më poshtë:

- Kompletimi i RVV-së për programin Bachelor dhe dërgimi i saj me të gjitha shtojcat në AKA;
- Përgatitja e mbrojtjes së programit me ekspertët ndërkombëtarë;
- Realizimi i mbrojtjes së programit Bachelor;

- Implementimi i pyetësorëve të përvitshëm për matjen e cilësisë nga ana e stafit akademik;
- Zhvillimi i matjeve të cilësisë përmes instrumenteve kualitativ me stafin akademik, studentët dhe stafin administrativ;
- Vlerësimi i të arriturave për programin Bachelor;
- Realizimi i pyetësorëve me Alumni dhe palët e jashtme të interesit për programin Bachelor;
- Themelimi i grupit punues për procesin e implementimit të përmirësimit rekomandimeve të ekspertëve të jashtëm në lidhje me riakreditimin e programin Bachelor.
- Implementimi i rekomandimeve të ekspertëve ndërkombëtare për programin Bachelor.

Prof. Asoc. Dr. Islam Qerimi



Dekan

Ky raport i dorëzohet:

1. *Rektorit të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini";*
2. *Prorektorit për mësim të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini";*
3. *Arkivit të Fakultetit.*